



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. *448* Prot.

Tiranë, më *22.05*.2025

NJOFTIM

PËR VEND PUNE

SPECIALIST JURIST I DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.32, datë 18.02.2025, "Për miratimin e strukturës dhe të organizatës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore", i ndryshuar, Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

1. Në pozicionin e specialistit Jurist, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Ai/Ajo punon nën drejtimin e Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së. Është pjesë e ekepeve të punës brenda institucionit dhe bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të stafit. Përgjegjësitë e pozicionit përfshijnë një gamë të gjerë të çështjeve të cilësisë në fushën e vlerësimit të aritjeve, të pranimit në shkollat e larta dhe të provimeve me fokus asistencën juridike për veprimtarinë e QSHA-së, hartimin e kontratave, konceptimin e akteve administrative dhe shkresave zyrtare të institucionit, mbikqyrjen e procedurave dhe dokumentacionin e prokurimeve, përfaqësimin e institucionit në marrëdhënie me gjykatat.

2. Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencat që kërkohen për këtë vend pune janë:

- ✓ Diplomë universitare në fushën e shkencave juridike. Diplomë Master dhe studimet pasuniversitare përbëjnë avantazh.
- ✓ Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune. Eksperiencat në institucione shtetërore përbën avantazh.
- ✓ Të ketë njohje të mirë të legjislacionit arsimor shqiptar dhe politikave të vlerësimeve arsimore dhe të strategjive të zbatimit të këtyre politikave.
- ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi shumë të mira gjuhësore dhe komunikimi në të shkruar dhe të folur. Të ketë njohuri mbi shkëmbimin akademik të gjuhës shqipe.
- ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi shumë të mira komunikimi në të shkruar dhe të folur në gjuhën Angleze. Njohuri në gjuhë të tjera të BE-së përbëjnë avantazh.
- ✓ Të ketë aftësi në përdorimin e programeve bazë kompjuterike;
- ✓ Të ketë aftësi në përdorimin në mënyrë efektive të dhënave informatike.
- ✓ Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të marrë iniciativë.
- ✓ Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe me afatë të ngushta kohore.
- ✓ Të ketë aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
- ✓ Të punojë vazhdimisht për zgjerimin e njohurive shkencore, profesionale dhe menaxheriale në mënyrë të dokumentuar.
- ✓ Të tregojë përkushtim ndaj misionit të institucionit.

Paga për pozicionin është në kategorinë IV-2.

Mundësi zhvillimi profesional i vijueshëm, trajnime profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 04.06.2025 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të notuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit si dëshmi të gjuhëve të huaja dhe të kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida MYRTO

